



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1001/1 prot.

Tiranë, më 26.10.2021

VENDIM

Nr.127, datë 26.10.2021

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT
TË KOMISIONERIT NR. 33, DATË 22.05.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 33, datë 22.05.2020, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë ”.

KONSTATOVA SE:

Me vendimin nr. 20, datë 13.02.2020, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në këtë institucion.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin Paralajmërues nr. 33, datë 22.05.2020, të Komisionerit, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, Instituti i Integritit të të Përndjekurve Politikë i ka dërguar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shkresën Nr. 282 Prot., datë 19.06.2020, “Kërkesë për miratim ndryshim strukture administrative”. Të njëjtën shkresë ia ka

përcjellë për dijëni edhe Komisionerit. Nga këqyrja e këtij akti dhe dokumentacionit bashkëlidhur u vu re se relacionit shpjegues për projekt-strukturën dhe organigramën e institucionit i mungonte një nga elementët formalë të aktit administrativ, siç është nënshkrimi i këtij akti.

Pas komunikimit të vazhdueshëm me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, dokumentacioni i rregullt është dërguar pranë Komisionerit në rrugë elektronike me e-mailin e datës 14.09.2021, të administruar në dosjen përkatëse.

Mbështetur në gjetjet e specifikuara në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, si dhe në detyrat e lëna për Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2**, i është lënë detyrë institucionit të materializojë në strukturë parimin e hierarkisë administrative në shërbimin civil duke propozuar në strukturën pasardhëse, krijimin e njësisë organizative me emërtesën “Drejtori”, me qëllim që të sigurohet linja e raportimit nga nivelet e ulta, në nivelin më të lartë (*Sektor-Drejtori-Drejtor i Përgjithshëm*) parashikuar në nenet 12-14, Kreu III “*Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore*”, Seksioni 2 “*Institucionet e varësisë*”, të ligjit nr. 90/2012, “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*”.

Konstatohet se, me aktin Nr. 281 Prot., datë 19.06.2020, “*Relacion shpjegues për projekt-strukturën dhe organigramën e Institutit të Integritit të ish të Përndjekurve Politikë (IIPP)*”, institucioni ka hartuar strukturën dhe organigramën e re, duke përfshirë në to njësinë organizative me emërtesën “Drejtori”, në përputhje me detyrën e lënë nga Komisioneri.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 33, datë 22.05.2020, “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Institutin e Integritit të të Përndjekurve Politikë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Instituti i Integritit të ish të Përndjekurve Politikë.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Integritit të ish të Përndjekurve Politikë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA